

Njoftim për përqendrim me të cilin AGNA – Shoqëri Aksionare, Republika e Shqipërisë do të fitojë kontroll mbi MAKO-MARKET SHPK Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

(lënda nr. 08-167/2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 25.11.2025, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës i është dorëzuar njoftimi për përqendrim, me të cilin AGNA – Shoqëri Aksionare me seli në Gjirokastër, Vrisera, Republika e Shqipërisë, synon të fitojë kontrollin e vetëm mbi kompaninë Shoqëria për tregti me shumicë dhe pakicë MAKO-MARKET SHPK Shkup, me seli të regjistruar në Shkup, në adresën rr. Boris Trajkovski nr. 288, Republika e Maqedonisë së Veriut.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

AGNA është shoqëri aksionare private, pronarë realë të së cilës janë personat fizikë Vasil Naçi, Kristo Naçi dhe Kosta Sotiri, shtetas të Republikës së Shqipërisë.

AGNA SHA Shqipëri ka si veprimtari kryesore tregtinë me shumicë dhe shpërndarjen e mallrave të konsumit të gjerë (FMCG), konkretisht produkte ushqimore, produkte për higjienën personale, produkte duhani, pije joalkoolike dhe alkoolike.

Si veprimtari plotësuese janë prodhimi dhe shitja e pijeve joalkoolike dhe alkoolike, logjistika dhe transporti i mallrave, si dhe veprimtari të lidhura me ndërtimtarinë, përfshirë investime në ndërtim, blerje dhe shitje toke, komplekse turistike, hotele dhe projekte të ngjashme infrastrukturore. Me operacionet e saj import-eksport, rrjetin e shpërndarjes, kapacitetet logjistike dhe aktivitetet prodhuese në sektorin ushqimor dhe të pijeve alkoolike, AGNA SHA Shqipëri paraqet një pjesëmarrës aktiv në tregun shqiptar të shpërndarjes, tregtisë dhe prodhimit të produkteve ushqimore dhe të konsumit të gjerë.

AGNA SHA Shqipëri është e pranishme në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes degës (filialit) të saj AGNA INVESTMENT SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në Mitropolit Teodosij Gologanov nr. 7 – Shkup, plotësisht në pronësi (100%) të AGNA SHA nga Shqipëria.

AGNA INVESTMENT SHPKNJP merret me dhënien me qira, menaxhimin dhe investimin në pasuri të paluajtshme. Më tej, AGNA INVESTMENT SHPKNJP Shkup është pronar i vetëm (me 100% pjesëmarrje) i PEVEC INTERNACIONAL SHPKNJP Shkup, shoqëri aktive në sektorin e ndërtimtarisë, me fokus në ndërtimin e objekteve banesore dhe ndërtimore të tjera (që është ende në fazë të dokumentacionit të projektit).

AGNA dhe subjektet e lidhura me të në tekstin e mëtejshëm do të quhen bashkërisht (“Grupi AGNA/AGNA”).

MAKO-MARKET SHPK Shkup ofron shërbime të tregtisë me shumicë të mallrave të konsumit të gjerë (ushqim, pije, produkte ëmbëlsirash/konfeksione, mjete për higjienën personale dhe mjete pastrimi), si dhe prodhim të produkteve të ëmbëlsirave dhe kokoshkave. Pjesën më të madhe të të ardhurave të saj.

MAKO-MARKET SHPK Shkup i realizon në tregun e brendshëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me një segment më të vogël të të ardhurave nga eksporti i prodhimit të vet.

MAKO-MARKET SHPK Shkup është e pranishme në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes qendrës logjistike, impiantit të prodhimit dhe rrjetit të zhvilluar të shpërndarjes dhe shitjes, me ekipin e vet të shitjes dhe rrjetin e vet logjistik e të shpërndarjes me automjetet e veta, përmes të cilave kryen shpërndarje direkte te blerësit e saj.

Sipas parashtruesit të njoftimit, tregu përkatës për përqendrimin në fjalë mund të përkufizohet si **tregu i tregtisë me shumicë të mallrave të konsumit të gjerë (FMCG) në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut**

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara që të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: Rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të mbërrijnë në Komision në afat prej 10 ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi.

27.11.2025

Shkup